

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT



PUNIM DIPLOME

KALTRINA PECI

Mitrovicë, 2019

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT



PUNIM DIPLOME

Rëndësia e gjuhës angleze në edukimin parashkollor

Mentori:

Prof.Ass.Dr.Edita Bekteshi

Kandidatja:

Kaltrina Peci

Mitrovicë, 2019

UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”

FACULTY OF EDUCATION

PRESCHOOL PROGRAM



DIPLOMA PAPER

The importance of English in preschool education

Mentors:

Prof.Ass.Dr.Edita Bekteshi

Candidate:

Kaltrina Peci

Mitrovicë, 2019

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI PARAFILLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda: Gjuhë angleze

Titulli i punimit: Rëndësia e gjuhës angleze në edukimin parashkollor

Emri dhe mbiemri: Kaltrina Peci

Statusi i studentit: I rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri): 1406021042

Niveli i studimeve: Bachelor

Programi i studimit: Parafillor

Mentori i punimit: Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi

Aprovuar prej komisionit:

1. (mentor)
2. (antarë)
3. (antarë)

Data e aprovimit: _____

Deklarata e autorësisë

Unë Kaltrina Peci studente në fakultetin e Edukimit Parafillor, deklaroj me përgjegjësi të plotë se ky punim i diplomës me titullin “ Rëndësia e gjuhës angleze në edukimin parashkollor” është i shkruar në mënyrë të pavarur dhe se ai është punimi im autorial. Gjithashtu deklaroj se punimi në fjalë nuk është i publikuar e as i përdorur për qëllime të kryerjes së obligimeve mësimore në këtë apo ndonjë institucion tjetër të shkollimit. Si dhe materialet e përdorura në këtë punim janë të cituara.

Nënshkrimi _____

Data _____

FALËNDERIMI

Falënderoj Zotin në rend të parë që më dhuroi shëndetin, familjen time të cilët në vazhdimësi më motivuan dhe ofruan përkrahje gjatë studimeve të mia.

Një falenderim special shkon për Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi për gjatë gjithë punës sime dhe për kontributin e finalizimit të punimit tim të diplomës, produkt i shumë orëve konsultimi, këshillimi dhe mbështetje nga ana e saj.

Po ashtu në fund dua të shpreh një falënderim dhe mirënjohje të thellë kolegëve konkretisht miqëve të mi për bashkëpunimin dhe përkrahjen nga fillimi dhe deri tek finalizimi me sukses i këtij udhëtimi sa të vështirë aq dhe të bukur.

Faleminderit të gjithëve!

Përmbajtja

ABSTRAKTI	8
ABSTRACT	9
1.Hyrje	1
1.2. Zhvillimi gjuhësor në moshën parashkollore	2
1.3. Zhvillimi i gjuhës dhe të folurit	2
1.4.Kurrikulat lëndore/programet mësimore	4
1.5.TEORITË E ZHVILLIMIT GJUHËSOR	5
1.5.1 Teoria e Piazhësë mbi zhvillimin kognitiv	6
1.5.2. Teoria nativiste e Chomskit	8
2.METODOLOGJIA	9
3.DISKUTIMET	11
3.1.Zhvillimi i fëmijëve që flasin dy gjuhë	11
3.2.Tingujt dhe shqiptimet	11
3.3. Zhvillimi Neurobiologjik i gjuhës	12
3.4. Periudha kritike për mësimin e gjuhës	13
3.5. Metodatat e përshtatshme për mësimin e gjuhës së huaj	15
3.6. Librat me ilustrime	17
4.KONKLUDIME DHE REKOMANDIMET	19
LITERATURA	22

ABSTRAKTI

Përmes këtij punimi synohet të tregohet aftësitë e fëmijëve për nxënien e gjuhës angleze, duke u njoftuar me karakteristikat e moshës parashkollore. Përmes mësimit të anglishtes si gjuhë e huaj do t'u mundësojë fëmijëve të zhvillojnë njohurit, aftësitë, mendimin kritik, kreativitetin, qëndrimet e nevojshme për të komunikuar në anglisht, bashkpunimin. Duke kushtuar rëndësi që fëmijët të kenë mundësi të mësojnë gjuhë angleze që në fazën e hershme, faze kjo që fëmijët shfaqin interes për të mësuar.

Qëllimi i këtij punimi është po ashtu t'u ipet hapësira dhe mundësia fëmijëve të mësojnë një gjuhë të huaj më shpejt. Duke u bazuar në zhvillimin e trurit, fëmija dita ditës pasuron fjalorin, aftëson të shqiptoj saktë tingujt e gjuhës që dëgjon dhe flet, kështu duke arritur shkathtësitë e gjuhës së hershme të fëmijës që mundëson të përshtaten me mjedisin në mënyrë që të jenë në gjendje të socializohen, bashkëveprojnë dhe t'u përgjigjen të tjerëve.

Gjithashtu përdorimi i metodave të ndryshëm të cilat mundësojnë që fëmijët të përvetësojnë një gjuhë të huaj sa më lehtë. Përmes shkimit të teorive dhe historisë së teorisë së zhvillimit të gjuhës, na ndihmon të mendojmë për zhvillimin e gjuhës nga këndvështrimet të ndryshme duke ilustruar mangësitë e këtyre teorive mbi shpjegimin e gjuhës. Pasi që kjo gjuhë po zhvillohet në vendin tonë mësimi i gjuhës angleze fillon që në fazën e parë dhe përparon në klasën e fundit të arsimit të mesëm të lartë. Faza e parë që synon rritjen e interesit të fëmijëve për këtë gjuhë në një mënyrë tërheqëse dhe njëkohësisht duke u dhënë mundësi fëmijëve të përvetësojnë fjalë, fjali dhe struktura të thjeshta në anglisht. Mësimdhënësit duke ofruar mundësi të shumta për fëmijët që të përfshijnë gjuhën angleze përmes lojërave, këngeve, roleve, vizatimeve dhe aktiviteteve të tjera praktike. Si dhe në fund është cekur përfshirja e librave me ilustrime të cilët kanë rëndësi në nxitjen e kureshtjes tek fëmijët.

Fjalë kyçe: Fëmijë, edukimi parashkollor, gjuhë e huaj.

ABSTRACT

This paper aims to show children the English language learning abilities by getting acquainted with the characteristics of preschool age. Learning English as a foreign language will enable children to develop the knowledge, skills, critical thinking, creativity, attitudes needed to communicate in English, and collaboration. The purpose of this paper is also to give children the opportunity and opportunity to learn a foreign language more quickly. Based on brain development, the child day by day enriches vocabulary, enables him to correctly pronounce the sounds of the language he is listening to and speaking, thus acquiring the child's early language skills that enable him to adapt to the environment in order to be able to socialize, interact, and respond to others. Also, using different methods that enable children to acquire a foreign language as easily as possible, these theories on the explanation of language. As this language is being developed in our country English language learning begins in the first phase and progresses to the last grade of upper secondary education. The first phase aims to increase children's interest in this language in an attractive and at the same time enabling children to learn simple English words, sentences and structures. Teachers providing numerous opportunities for children to incorporate English through games, songs, roles, drawing and other hands-on activities. Finally, it is mentioned the inclusion of illustrated books that are important in encouraging curiosity in children.

Keywords: Children, pre-school education, foreign language.

1.Hyrje

“One book, one pen, one child, and one teacher can change the world”

-Malala Yousafazi

Klasa parafillore është pjesë e sistemit të obliguar arsimor të Kosovës. Kjo fazë paraqet rëndësi të madhe të zhvillimit e cila fokusohet në nxitjen e kureshtjes të fëmijes për veten, familjen, shoqërinë, botën në përgjithësi, apo edhe teknologjitë e reja. Kjo periudhë gjithashtu inkurajon fëmijët të zhvillojnë aftësi të komunikimit dhe të shprehurit në gjuhën amtare, përqëndrimit dhe socializmit .Ne jetojmë në një botë multikulturore dhe shumëgjuhëshe, e cila e bën që individi, përveç gjuhës së tij amtare të mësojë dhe të përdori një gjuhë tjetër të synuar e cila është bërë një domosdoshmëri për të mbështetur zhvillimin personal.

Një mjedis i pasur me gjuhë është ai në të cilin fëmijët janë të rrethuar duke folur, kënduar dhe lexuar, për të komunikuar me të tjerët dhe për t'u përfshirë në biseda. Një mjedis i pasur gjuhësor është i rëndësishëm për mësimin e hershëm të fëmijëve dhe mund të ketë efekte të forta në aftësitë e hershme të gjuhës, fjalorit, leximit dhe matematikës, si dhe në zhvillimin social-emocional të fëmijëve.

Kur flitet për fëmijë, fëmijët e grupmoshë 5-6 vjeç fillojnë të jenë të rrjedhshëm në lidhjen e tingujve, rrokjeve dhe lidhjes së fjalëve që kanë kuptim së bashku në një mendim. Ata fillojnë të marrin pjesë në biseda të shkurtra me të tjerët. Në fillim të kësaj faze, të vegjëlit kanë tendencë të mos mungojnë fjalët funksionale dhe keqkuptojnë se si të përdorin kohëzgjatjet e foljeve. Kohë që ata fillojnë të përfshijnë fjalë funksionale ,përemrat dhe foljet ndihmëse. Conti-Ramsden, Gina (2012). Kjo është faza në të cilën shumica e fëmijëve mund të marrin sugjerime emocionale të tonit të bisedës për të rriturit. Nëse reagimi negativ dallohet nga fëmija, kjo përfundon me frikë dhe shmangie të shenjave të lidhura verbale dhe joverbale. Të vegjëlit zhvillojnë aftësitë për të dëgjuar dhe pjesërisht të kuptojnë se çfarë po thotë një person tjetër dhe mund të zhvillojnë një përgjigje të përshtatshme.

Kur bëhet fjalë për nxënien e një gjuhe të huaj, është i njohur fakti se mënyra më e mirë për të mësuar një gjuhë të huaj është që t'i ekspozohet sa më shumë që të jetë e mundur dhe të fitojë në mënyrë të natyrshme. Nëse fëmijët janë në një mjedis të gjuhës angleze, në të cilin ata ndihen rehat

dhe të sigurtë ata janë në gjendje të absorbojnë shqiptimin e anglishtes dhe fjalët e reja shumë lehtë dhe me efekt afatgjatë. Megjithatë zhvillimi gjuhësor, në të vërtetë, është zhvillimi i shumë pjesëzave të një sistemi gjuhësor që duhet të evoluojë dhe të punojë në një rend për të përmbushur “rezultatin” e të folurit human (Hirsh-Pasek, K., & Golinkoff, R. M,2002).

1.2. Zhvillimi gjuhësor në moshën parashkollore

Fëmijëria e hershme sipas psikologjisë së zhvillimit është mosha nga 2 vjeç deri në 6 vjeçe cila njihet edhe si mosha parashkollore .Parashkollorët(preschools) kanë ndryshime të dukshme, si në aspektin fizik edhe në atë konjitiv. Veçanërisht është i dukshëm gjatë viteve të fëmijërisë së hershme që përfshin:ndryshimet biologjike, psikologjike, që ndodhin në këtë kohë janë të ndërlidhura.

Zhvillimi i aftësive gjuhësore për fëmijërinë e hershme synon që fëmijët të komunikojnë në mënyrë verbal me mjedisin përreth, duke përfshirë miq, shokë,të rritur,qoftë në shkollë,në shtëpi, ose me fqinjët përreth. Shkathësitë e gjuhës së hershme të fëmijës mundëson që të përshtaten me mjedisin në mënyrë që fëmijët të jenë në gjendje të socializohen,bashkëveprojnë dhe t'u përgjigjen të tjerëve.

Gjuha ndikohet nga shumë faktorë si biologjikë, kulturorë dhe të jetës së përditshme. Për të zotëruar një gjuhë, fëmijët duhet të kuptojnë qëllimet e të tjerëve për të mësuar fjalët, frazat dhe konceptet e gjuhës së tyre dhe të dallojnë strukturat dhe modelet në të cilat njerëzit e tjerë i përdorin këto fjalë dhe fraza në përputhje me gramatikën e gjuhës (Tomasello,2016). E rëndësishme është që fëmijët të mësojnë gjuhën duke u përpjekur që në mënyrë aktive të nxjerrin kuptimin e saj që dëgjojnë dhe të dallojnë modelet dhe rregullat e gjuhës.

1.3. Zhvillimi i gjuhës dhe të folurit

Fjalori dhe struktura e fjalive të fëmija pasurohet dita ditës përmes aktivitetit të tij shoqëror dhe aftësisë njohëse. Fëmija (child) është mësuar të shqiptojë saktë tingujt e gjuhës që dëgjon dhe flet. Në moshën 6-7 vjeç, kur fëmija fillon të ndikohet nga programi shkollor, ku përveç librit të

alfabetit, njohuri të përgjithshme të marra nga sistemi parashkollor, fëmija gjithashtu fillon të mësojë disiplina të tjera siç janë leximi letrar ose matematika. E gjithë periudha parashkollore është ajo që do të përcaktojë të ardhmen e tij / saj akademike.

Gjuha është mjete kryesor i komunikimit si dhe një nga elementët kryesorë që ndikon, në çdo aspekt të jetës dhe zhvillimit të individit. Imitimi dhe përforsimi luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin gjuhësor. Padyshim, që nuk është e rastësishme që fëmijët flasin të njëjtën gjuhë të prindërve të tyre dhe me dialektin dhe theksin që edhe ata e flasin. Kështu, fëmijët përforsohen për fjalët dhe fjalitë që imitojnë, por ata gjithashtu përforsohen edhe për përdorimin e formave të reja gramatikore (Shaffer, D. R., & Kipp, K, 2007). Sa më shumë zgjerohet fjalori i fëmijëve, aq më i lehtë bëhet mësimi i fjalëve të reja. Kjo ndodh kryesisht për shkak të efektit paradigm. Kjo do të thotë se fëmijët arrijnë të kuptojnë marrëdhëniet pragmatike mes fjalëve dhe mund të mësojnë shumë shpejt fjalë të reja që mbushin hapësirat boshe në paradigmen e tyre.

Pra, sapo fëmija të ketë mësuar mirë ngjyrat (colors): e kuqe, e verdhë, e gjelbërt, e kaltërt, e zezë dhe e bardhë, ata mund të fillojnë të mësojnë ngjyrat më pak të zakonshme si rozë apo portokall. (De Temple, J., & Snow, C. E, 2003). Për këtë arsye, në moshën parashkollore pritet një zhvillim më i shpejtë dhe më i plotë i fjalorit dhe përdorimit të gjuhës, duke qenë se tashmë janë krijuar bazat linguistike. Aftësitë gjuhësore vazhdojnë të përmirësohen gjatë fëmijërisë së hershme. Gjuha është rezultati i aftësisë së fëmijëve për të përdorur simbolet. Ndërsa truri i tyre zhvillohet dhe fitojnë aftësinë për të menduarin përfaqësues, fëmijët gjithashtu mësojnë dhe përmirësojnë aftësitë gjuhësore. Parashkollorët mësojnë shumë fjalë të reja. Prindërit, motrat ose vëllezërit, bashkëmoshatarët, mësuesit dhe media ofrojnë mundësi për parashkollorët që të rrisin fjalorin e tyre. Në këtë mënyrë, mësimi i gjuhës ndodh brenda një konteksti social dhe kulturor. Fëmijët mësojnë, gjithashtu, rreth shoqërisë ndërsa mësojnë gjuhën. Vlerat, normat, zakonet, rregullat informale dhe formale të sjelljeve transmetohen nga mënyra sesi prindërit dhe të tjerët tregojnë përdorimin e fjalëve (Zgourides, G, 2000).

Duke u nisur nga fakti se çka u tha më lartë për mësimnxënien, në mënyrë të tillë mund të diskutohet edhe për mësimin e gjuhës tjetër, psh: gjuhës angleze në edukimin parashkollor. Sidoqoftë, çdo proces edukativ nisët nga rregulloret e lëshuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, ku të gjitha aktivitetet janë të përfshira në kurrikulat përkatëse.

1.4.Kurrikulat lëndore/programet mësimore

Meqenëse mësimi i gjuhës angleze fillon që në fazën e parë dhe përparon në klasën e fundit të arsimit të mesëm të lartë. Faza e parë duhet të synojë rritjen e interesit të fëmijëve për këtë gjuhë në një mënyrë tërheqëse dhe njëkohësisht duke u dhënë mundësi fëmijëve të përvetësojnë fjalë, fjali dhe struktura të thjeshta në anglisht. Mësimdhënësit (teachers) duhet të ofrojnë mundësi të shumta për fëmijët që të përfshijnë gjuhën angleze përmes lojërave, këngëve, roleve, vizatimeve dhe aktiviteteve të tjera praktike.

Gjatë arsimit të tyre, në programin e gjuhës angleze, fëmijët do të marrin njohuri dhe aftësi rreth:

- Interpretim, shprehje, komunikim.
- Tingujt, simbole të shkruara, fjalor.
- Procesi kognitiv, socio-konjitiv dhe met-njohës (edukimi i përgjithshëm i gjuhës).
- Modelet e ideve, sjelljeve, manifestimeve, objekteve kulturore dhe simboleve (kulturës).

Përvetësimi i gjuhës (Language acquisition) përfshin aftësi komunikimi si dëgjimi, të folurit, leximi, shkrimi, shikimi dhe shfaqja. Fëmijët zhvillojnë këto aftësi komunikimi duke përdorur njohuri për gjuhën, duke përfshirë gramatikën, dhe kulturën, strategjitë e komunikimit dhe të të mësuarit, teknologjinë dhe përmbajtjen nga fushat e tjera lëndore për t'u shoqëruar, për të marrë dhe siguruar informacion, për të shprehur ndjenja dhe mendime, por aftësitë e komunikimit janë fokusi kryesor i përvetësimit të gjuhës (MASHT,2017).

Qasja e përgjithshme gjatë viteve fillestare të përvojave të mësimin të gjuhës angleze do të përqëndrohet në aspektin jo-analitik (të mësuarit si komunikim përmes ndërveprimit pa studim të thelluar të elementeve gjuhësore).Ndërsa përparojnë në përvojën dhe kompetencën e tyre gjuhësore, në fazat e mëvonshme përqendrimi do të zhvendoset drejt një qasje më analitike, por gjithmonë duke mbajtur një ekuilibër midis të dyve (MASHT,2017)

Meqenëse komunikimi në thelb nënkupton dërgimin dhe pranimin e mesazheve, fëmijët duhet të zhvillojnë disa aftësitë gjuhësore, të cilat janë thelbi i komunikimit. Zhvillimi i aftësive pritëse, domethënë aftësitë e të dëgjuarit dhe të lexuarit, do t'u mundësojë fëmijëve të marrin mesazhe dhe, në varësi të detyrave që pritet të kryejnë, të zgjidhni informacionin thelbësor.

Mësuesit duhet të bëjnë përpjekje për ta mbajtur në minimum përdorimin e gjuhës amtare. Në vend që të përkthenin fjalë ose kërkojnë nga nxënësit të përkthenin, ata duhet të demonstrojnë, veprojnë,

përdorin vizatime të thjeshta ose fotografi, të shpjegojnë, të japin përkufizime të thjeshta. Nëse mësuesit ndërhyjnë me gatishmëri në përkthim, sapo nxënësve t'u jepet një fjalë ose shprehje "ekuivalente",sa më shpejt që kurioziteti i tyre të jetë i kënaqur, ata mund të humbasin interesin për atë artikull të veçantë. Si pasojë, fjala ose shprehja angleze harrohet lehtë dhe nuk mund të tërhiqet lehtë. Kjo metodë është më e lehtë për mësuesit dhe nxënësin,e cila mund të jetë më pak e paharrueshme (MASHT,2017).

Programi i Gjuhës Angleze Grade Zero integron tema që lidhen drejtpërdrejt me lëndë të tjera, siç janë: artet, kultura, gjeografia, letërsia në media, edukimi qytetar, dhe të ngjashme. Të gjitha këto janë në funksion të pajisjes së fëmijëve me para së gjithash kompetencën komunikuese, si dhe kompetencat e tjera të parashikuara në Kurrikulën Themelore Nivelin Një. Gjatë kësaj shkalle, fëmijëve u sigurohen mundësi për të mësuar rreth çështjeve ndërkurrikulare, ndërsa njëkohësisht përvetësojnë dhe forcojnë fjalë, fraza dhe fjali të thjeshta në gjuhën angleze (MASHT,2017).

Përveç kësaj, mësuesit inkurajohen të përdorin materiale shtesë për t'iu përshtatur nevojave të fëmijëve, d.m.th., njohuritë e tyre në bazë të interesave të tyre dhe motivimit. Materialet plotësuese (kaseta video, filma dokumentarë, aktivitete drama, projekte, konkurse dhe kuize, dhe të ngjashme), mund të përdoren ose brenda orëve të rregullta në anglisht, ose brenda aktiviteteve shtesë të planifikuara nga kurrikula e shkollës). Duke u bazuar në MASHT(2017)qasja e përgjithshme gjatë viteve fillestare të përvojave të mësimit të gjuhës angleze do të përqëndrohet në aspektin jo-analitik (të mësuarit si komunikim përmes ndërveprimit pa studim të thelluar të elementeve gjuhësore). Mësimdhënësit duhet të ofrojnë mundësi të shumta për fëmijët që të përfshijnë gjuhën angleze përmes lojërave, këngëve, roleve, vizatimeve dhe aktiviteteve të tjera praktike.

1.5.TEORITË E ZHVILLIMIT GJUHËSOR

Pra, pasi prindërit dhe mësuesit i ndihmojnë fëmijëve të flasin, ata duhet të kuptojnë se nuk ka një teori të qartë që shpjegon se si fëmija mëson gjuhën që u nevojiten për t'u bërë të aftë në lexim dhe komunikim. Sidoqoftë, ekzistojnë disa teori kryesore që janë zhvilluar për të shpjeguar mësimin e gjuhës e sjellje, gjuhësore dhe ndërvepruese. Shikimi i teorive dhe historisë së teorisë së zhvillimit të gjuhës na ndihmon të mendojmë për zhvillimin e gjuhës nga këndvështrime të ndryshme. Mangësitë e këtyre teorive ilustronë se gjuha nuk shpjegohet lehtë.

1.5.1 Teoria e Piazhës mbi zhvillimin kognitiv

Në zhvillimin e tyre konjitiv (cognitive), parashkollorët bëjnë përpjekjet e tyre për të kuptuar, shpjeguar, organizuar, manipuluar, ndërtuar dhe parashikuar. Në bazë të ngjarjeve dhe modeleve të objekteve të cilat i shohin në botë, ata përpiqen që t'i organizojnë ato në modele për të shpjeguar botën. Fëmijët kanë vështirësi në funksionet e kujtesës, kontrollin e vëmendjes, fokusohen në një aspekt të eksperiencës në një moment të caktuar, duke krijuar njëkohsisht kufizime konjitive.

Teoria e zhvillimit njohës të Piazhës (1936) thotë se aftësitë tona konjitive zhvillohen përmes katër fazave specifike, të cilat korrespondojnë me moshën e fëmijës; ato përfshijnë fazat operacionale të sensorit, para operacionit, konkrete dhe operacionale.

- Faza sensorimotore ndodh që nga lindja deri në moshën 2 dhe karakterizohet nga ideja që foshnjat "mendojnë" duke manipuluar botën përreth tyre.
- Faza para operacionit ndodh nga mosha 2 deri në moshën 7 vjeç dhe karakterizohet nga ideja që fëmijët përdorin simbole për të përfaqësuar zbulimet e tyre.
- Faza konkrete operative ndodh nga mosha 7 deri në moshën 11 vjeç dhe karakterizohet nga ideja që arsyetimi i fëmijëve bëhet i përqendruar dhe logjik.
- Faza zyrtare operative ndodh që nga mosha 11 deri në moshën madhore dhe karakterizohet nga ideja që fëmijët zhvillojnë aftësinë për të menduar në mënyra abstrakte.

Faza para operacionit ndodh nga mosha 2 deri në moshën 7. Gjatë kësaj faze, fëmijët mund të përdorin simbole për të përfaqësuar fjalë, imazhe dhe ide, kjo është arsyeja pse fëmijët në këtë fazë përfshihen në pretendime për lojërë. Krahët e një fëmije mund të bëhen krahë të aeroplanit. Zhvillimi i gjuhës dhe loja e besimit fillojnë në këtë fazë. Mendimi logjik ende nuk është i

pranishëm, kështu që fëmijët nuk mund të kuptojnë idetë më komplekse. Gjatë kësaj faze fëmijët fillojnë të përdorin gjuhën, kujtesa dhe imagjinata gjithashtu zhvillohen.

Në fazën paraoperacionit, fëmijët angazhohen të besojnë dhe të kuptojnë marrëdhënien midis së kaluarës dhe të ardhmes. Konceptet më komplekse, siç janë marrëdhëniet shkak dhe pasojë, nuk janë mësuar. Inteligjenca është egocentrike dhe intuitive, jo logjike.

Ai përdori termin operacionale për t'iu referuar aftësive të kthyeshmërisë, veprimeve mendore dhe fizike që shkojnë në drejtime të ndryshme. Sipas Piazhës, fëmijët gjatë kësaj faze, mund të mendojnë për gjërat në mënyrë simbolike. Kjo është aftësia për të bërë një gjë, një fjalë ose një objekt të qëndrojnë për diçka tjetër përveç vetvetës. Mendimi është akoma egocentrik, dhe fëmija ka vështirësi të marrë pikëpamjen e të tjerëve, përdorin të menduarin magjik, i cili bazohet në aftësitë e tyre shqisore dhe perceptive dhe që janë lehtësisht të çorientuara (Zgourides, G. 2000).

Piazhe besonte se aftësitë konjitive të parashkollorëve kufizohen nga egocentrizimi, që nënkupton pamundësinë për të bërë dallimin ndërmjet pikëpamjes të vetë fëmijës dhe asaj të të tjerëve. Mendimet dhe komunikimet e fëmijëve janë zakonisht egocentrike (d.m.th. për veten e tyre). Egocentrizmi i referohet paaftësisë së fëmijës për të parë një situatë nga këndvështrimi i një personi tjetër. Sipas Piazhës, fëmija egocentrik supozon se njerëzit e tjerë shohin, dëgjojnë dhe ndjehen saktësisht njësoj siç bën fëmija. Kapaciteti për të qenë egocentrik është i dukshëm tek të gjithë stadiet e zhvillimit konjitiv, por ai është më i dukshëm gjatë viteve parashkollore.

Në dallim nga teoritë e Piazhës mbi egocentrizmin e fëmijës, studime të ngjashme kanë treguar se fëmijët munden dhe arrijnë të lidhen me kornizën e referencës së të tjerëve. Tipikisht, 5 vjeçarët janë të interesuar në mënyrën sesi funksionon mendja e tyre dhe e të tjerëve. Studimet e kohëve të fundit për moshën 2-5 vjeç kanë treguar se ndryshe nga supozimet e Piazhës, fëmijët e stadiet paraoperacionale mendojnë logjikisht, projektojnë veten e tyre në situatat e të tjerëve dhe interpretojnë mjedisin përreth. Pra, cilësitë konjitive të stadiet paraoperacionale të Piazhës mund të jenë të vlefshme për disa fëmijë, por nuk vlejnë për të gjithë njësoj. Parashkollorët nuk kujtojnë aq mirë sa fëmijët më të rritur dhe të rriturit. Mirëpo këta fëmijë janë më të mirë në rinjohje sesa në kujtesë. Parashkollorët, shfaqin interes të madh për të mësuar. Kjo do t'i çojë në një proces të përshpejtuar të zhvillimit konjitiv. Për shembull, ata do të arrijnë zhvillim të shpejtë të të folurit dhe të njohjes së tekstit, të cilat janë paraprijëse të zhvillimit të aftësive lexuese në fëmijët e vegjël. Fëmijët me kujtesë pune më të zhvilluar do të jenë më të aftë të zhvillojnë gjuhën dhe leximin dhe ta kontrollojnë atë në një nivel sa më të lartë (Sigelman, C. K., & Rider, E. A. 2009).

1.5.2. Teoria nativiste e Chomskit

Chomski tha në 1978: Gjuha më duket se rritet në mendje, përkundrazi në mënyrën se si rriten sistemet fizike (physical system) të njohura të trupit. Ne fillojmë shkëmbimin tonë me botën me mendjet tona në një gjendje të caktuar gjenetikisht të përcaktuar, dhe përmes bashkëveprimit me një mjedis, me përvojë, kjo gjendje ndryshon derisa të arrijë një gjendje të pjekur mjaft të qëndrueshme, në të cilën ne posedojmë atë që ne e quajmë njohuri të gjuhës. Struktura e mendjes, në këtë gjendje të pjekur (dhe në të vërtetë edhe në gjendje të ndërmjetme), përfshin një sistem kompleks të përfaqësimeve mendore dhe parimeve të llogaritjes në ato përfaqësime mendore. Kjo sekuençë ndryshimesh nga gjendja fillestare e përcaktuar gjenetikisht në gjendjen e qëndrueshme përfundimtare më duket në shumë aspekte analoge me rritjen e organeve tona. Këto organe rriten si rezultat i përvojës nxitëse të përvojës, e cila i formëson dhe artikulon ato ndërsa ato zhvillohen tek individit gjatë periudhës përkatëse të jetës së tij.

Që nga viti 1957 ka pasur një ndryshim të dukshëm në qasjen ndaj studimit të gjuhës së fëmijëve. Ndryshimi ishte drejt analizës gjuhësore (linguistic analysis). Në vend që të shikojmë vetëm shprehjet e fëmijës, bëhet përpjekja për të kuptuar se cilat rregulla ishin ato që prodhuan rezultatin. Arsyeja e ndryshimit të theksit në gjuhësinë zhvillimore është ardhja e punës për gramatikën transformuese nga Noam Chomski(1957). Njerëzit po përpiqeshin të zbulonin se cilat ishin rregullat dhe si ndryshuan me kohën.

Noam Chomsky i shqyrtoi çështjet që lidhen me mësimin e gjuhës nga një prespektivë racionale. Ai propozoi se gjuha përbëhet nga dy elementë, kompetenca (sistemi i rregullave që zotërohen nga folësi i gjuhë amtare, njohuria për gjuhën dhe performanca), (përdorimi aktual i gjuhës nga folësi, sjelljet e shumta verbale me të gjitha paqëndrueshmëritë dhe gabimet). Sipas këndvështrimit të Chomski-t roli i gjuhëtarit është ta studiojë kompetencën linguistike(Chomsky,N.2006).

Chomski e bazoi teorinë e tij në konceptin e aftësisë së lindur (ndaj dhe rryma u quajt nativizëm) për të mësuar gjuhën. Sipas tij, mësimi i gjuhës është biologjikisht dhe genetikisht i paraprogramuar dhe nuk varet nga aftësitë intelektuale të fëmijës ose stimujt e mjedisit. Ai

konkludoi se fëmijët do të mësonin gjuhën e tyre të parë ose të dytë me sukses edhe nëse nuk do të kushtohesh një kujdes i veçantë për t'ua mësuar atë apo për të monitoruar progresin e tyre (Chomsky, N. 1965).

Mësimi i gjuhës mund të shihet si një tranzicion i gjendjes së mendjes në lindje, gjendja fillestare konjitive në një gjendje më të qëndrueshme që korrespondon me njohjen e gjuhës amë. Pikëpamjet mbi stimulimet e pakta mbështesin idenë se gjendja fillestare konjitive, larg nga pikëpamja empirike e tabula rasa, është një sistem mjaft i strukturuar. Këtë gjendje fillestare konjitive ai e quajti gramatika universal.

Chomski (2004) argumenton se aftësia e fëmijëve (the ability of children) për të mësuar gjuhë është për shkak të një organi të programuar gjenetikisht që ndodhet në tru. Pasi fëmijët lindin dhe përfshihen në mjedise gjuhësore, ata menjëherë fillojnë të zhvillojnë një gjuhë. Sidoqoftë, për ta bërë këtë, fëmijët duhet të përdorin mjetin e vetëm që ata kanë në dispozicion, gramatik e tyre lindore mendore.

Chomski (2004) e karakterizon këtë si Gramatikë Universale (Universal Grammar). Përmes saj foshnjat e porsalindura kanë në dispozicion të tyre gramatikën e çdo gjuhe që egziston në botë. Pasi fëmijët lindin dhe i ekspozohen një gjuhe ose gjuhë të veçantë në mjedis, ata e lidhin gjuhën me Gramatikën Universale dhe ajo gjuhë bëhet gjuha amtare. Sipas Chomski (2004), Gramatika Universale është në dispozicion për të sapolindurit para se të fillojë përvoja e tyre gjuhësore. Si i tillë, Gramatika Universale është në dispozicion të fëmijëve në gjendjen fillestare të mësimi të gjuhës së tyre.

Duke u nisur nga ajo se cka u tha më lartë, ky punim ka qëllim të diskutojë gjuhën angleze tek parashkollorët. Më saktësisht, ky shqyrtim i literatures ka për qëllim të hulumtojë marrdhëniet ne mes moshës d.m.th moshes parashkollore dhe nxënies së gjuhes së huaj, në rastin tonë, nxënies së gjuhës angleze. Si qëllim, ky punim do t'í përgjigjet këtyre pyetjeve të parashtruara:

- 1.Cka ndikon në nxënien e gjuhës angleze te femijët parashkollor?
- 2.Cilat janë metodat më të përshtatshme për të mësuar një gjuhë të huaj një fëmijë parashkollor?

2.METODOLOGJIA

Të dhënat kryesore për realizimin e këtij punimi ka qenë në bazë të kërkimit në literatura. Metoda e grumbullimit të të dhënave është rishqyrtim i literatures, duke shfrytëzuar libra, literature nga burimet e ndryshme shkencore nga interneti siç janë:

Brown,H.D. (2001); Locke,J.L.(1997); Asher, J. (2007); Buddenhagen, R. G. (1971); Brown, H.D. (2001); Snowling,M.J.(2006); Hurford, J. R. (1991); Fang,Z.(1996); Larsen-Freeman,D.(2000); DeTemple,J.,&Snow,C.E.(2003). Learnin words from books. Shin, J. K. (2014); si dhe .Hahn,M.L. (2002). Reconsidering Read-Aloud..

Ky punim është shqyrtim literature që ka të bëjë me nxënien e gjuhës, respektivisht të gjuhës së huaj tek fëmijët e moshës parashkollore. Kjo sintezë e literatures do të shpjegojë se si gjuha e huaj, gjuha angleze është pjesë përbërëse e zhvillimit të avancuar të fëmijes .

Metodologjia që është përdorur për këte punim ka qasje kuantitative sa i përket punimeve që janë marrë në shqyrtim, dhe qasje kualitative kur ka të bëjë me teorine në ato punime. Artikuj të ndryshem dhe sinteza e tyre janë marrë parasyshë për të shtuar fakte/njohuri të reja dhe pastaj të konkludojmë për pyetjet e parashtruara.

3.DISKUTIMET

3.1.Zhvillimi i fëmijëve që flasin dy gjuhë

Fëmijët dy gjuhë (bilingual) mund të kenë një fjalor më të madh në gjuhën në të cilën mësojnë nga personi në të cilën kalojnë më shumë kohë apo kanë lidhje më të ngushtë. Me kalimin e kohës, këta fëmijë mund të bëhen plotësisht dy gjuhë, nëse ekspozimi ndaj gjuhës së dytë zhvillon herët në jetë, ndodh në një diapazon të gjerë dhe të larmishëm situatash dhe është i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm (Petitto & Kovelman, 2012). Fëmijët dy gjuhësh mund të përzijnë fjalorët e të dy gjuhëve kur flasin, por kjo nuk është domosdoshmërisht shenjë se ata ngatërrohen, mirëpo me angazhim të vazhdueshëm në të dy gjuhë fëmijët mund të bëhen plotësisht dy gjuhësh. Sa më herët që njeriu të mësojë një gjuhë të dytë, aq më afër të folurit original do të jetë shqiptimi i tij. Pas adoleshencës është e vështirë të flitet një gjuhë e dytë pa aksent (Anderson & Graham, 1994). Edhe nëse një fëmijë e dëgjon një gjuhë, pa e mësuar atë në mënyrë sistematike, kjo mund të lehtësojë mësimin e gjuhës në një fazë të mëvonshme.

Bazuar në një studim me nxënësit që mësonin spanjisht, Terry Au dhe bashkëpunëtorët e saj arritën në përfundim se: “ Ndonëse të presësh sa të rritesh për të mësuar një gjuhë të dytë është garanci për aksent të keq, fakti që mund ta kesh dëgjuar atë gjuhë në fëmijëri duket se lehtëson shumë këtë process” (Au, Knightly, Jun & Oh, 2002, f.242). Pra, koha më e mirë për të mësuar një gjuhë të dytë është, gjatë fëmijërisë së hershme (early childhood) apo të mesme, por koha më e mirë për të mësuar dy gjuhë pa mësues, përmes ekspozimit ndaj tyre si dhe për të mësuar shqiptimin e natyrshëm është fëmijëria e hershme.

3.2.Tingujt dhe shqiptimet

Gjuha dhe të folurit (language and speech) janë vazhdimisht në zhvillim dhe në ndryshim në varësi të eksperiencave jetësore. Ajo fillon të shfaqet qysh në foshnjërinë e hershme, rreth moshës 3-6 muajsh, kur fillojnë tingujt dhe belbëzimet e para dhe zhvillohet me një ritëm shumë të shpejtë deri rreth moshës 6 vjeç, kur fëmija është i aftë të shqiptojë saktë tingujt e gjuhës që ai flet. Në moshën 18 muajsh fëmija fiton vrullin e fjalorit dhe në 2 vjeç arrin të ndërtojë një fjalor të

konsiderueshëm prej rreth 200-300 fjalësh si dhe të ketë filluar të formojë fjali dy-fjalëshe (të folurit telegrafik). Periudha parashkollore (the preschool period) është ajo që do të përcaktojë të ardhmen e tij akademike, ku fëmija dita ditës pasuron fjalorin, aftëson të shqiptoj saktë tingujt e gjuhës që dëgjon dhe flet.

Shumica e fëmijëve arrijnë të zotërojnë tingujtë e gjuhës amtare, deri në moshën 5 vjeçare, mirëpo mund të kenë mbetur edhe disa tinguj të pazotëruar plotësisht. Në gjuhën angleze, përgjithsishtë tingujt *j* dhe *v*, si dhe grupet e bashkëtingëlloreve *th*, *zh*, *str*, *sl* dhe *dr* zotërohen të fundit (Owens, 2005). Fëmijët e vegjël mund të kuptojnë dhe janë të aftë të përdorin shumë fjalë, por parapëlqejnë të përdorin fjalët që arrijnë t'i shqiptojnë më lehtë. Kur fillojnë të kuptojnë dallimet në tingujt e gjuhës, fëmijëve fillojnë t'u pëlqejnë rimat, këngët dhe kombinimet e fjalëve që tingëllojnë bukur. Fëmijët në moshën 2-3 vjeçare janë në gjendje të përdorin rreth 450 fjalë, edhe pse ata janë të aftë të kuptojnë shumë më tepër. Në moshën 6 vjeçare, fjalori shprehës i fëmijëve rritet në rreth 2.600 fjalë, kures fjalori receptive përfshien rreth 20.000 e më shumë fjalë (Owens, 2005).

3.3. Zhvillimi Neurobiologjik i gjuhës

Neurobiologjia merret me përbërjen fizike të sistemit nervor, përfshirë neuronet dhe organizimin e tyre në qarqe që lejojnë sjellje komplekse si gjuha të ndodhin.

"Truri si kompjuter" është një metaforë e zakonshme për karakterizimin e trurit si produkt i aftësive të tij të lokalizuara (Tooby and Cosmides, 2005).

Zhvillimi i trurit (brain development) – Zhvillimi i trurit dhe sistemit nervor gjatë fëmijërisë së hershme vazhdon të jetë mjaft i shpejtë. Aftësitë konjitive dhe sjellore arrihen kur sa më mirë të zhvillohet truri dhe sistemi nervor. Lateralizimi (ndarja e trurit në hemisferën e majtë dhe të djathtë) i referohet lokalizimit të funksioneve dhe aftësive të ndryshme në njërin ose të dyja hemisferat. Kryesisht, gjuha, shkrimi, logjika, matematika mendohet se ndodhen në hemisferën e majtë, ndërsa kreativiteti, fantazia, aftësitë artistike dhe muzikore ndodhen në hemisferën e djathtë. Edhe pse këto hemisferat kanë funksione të ndara, pjesë të trurit gjithmonë i koordinojnë funksionet dhe punën së bashku. Zhvillimi i tyre arrihet me shkallë të ndryshme, ku hemisfera e majtë zhvillohet më plotësisht në fëmijërinë e hershme (2 deri në 6 vjeç) dhe hemisfera e djathtë zhvillohet më plotësisht në fëmijërinë e mesme (mosha 7 deri në 11 vjeç). Hemisfera e majtë

zhvillohet më herët dhe më gjatë, kjo tregon edhe faktin se pse fëmijët mësojnë gjuhën shumë herët dhe shpejt.

Sistemi nervor (nervous system), po ashtu, pëson një mori ndryshimesh në fëmijërinë e hershme. Shumica e neuroneve të fëmijës ose të qelizave nervore, formohen që në periudhën prenatale. Megjithatë, qelizat glia (qelizat që mbështesin sistemin nervor, duke rrethuar neuronet) të cilat izolojnë dhe heqin mbetjet nga neuronet pa njoftuar vet informacion, zhvillohen më shpejt gjatë foshnjërisë dhe fëmijërisë së hershme. Zhvillimi paslindjes, i qelizave gliale dhe membranës mielin shpjegon se pse fëmijët më të rritur kryejnë sjellje që fëmijët e vegjël nuk janë në gjendje t'i bëjnë.

Aftësitë e gjuhës së folur përbëjnë bazë për zhvillimin e më tej të aftësive të leximit dhe të shkrimit. Studime të ndryshme modifikojnë aftësitë e të folurit nga aftësitë gjuhësore kur i adresohen zhvillimit të leximit dhe shkrimit. Njohuritë më të përfshira të gjuhës kërkojnë kuptimin e fjalëve dhe fjalive, për t'i bashkuar këto në tekste dhe për të mundësuar ndërhyrjet që shkojnë përtej fjalëve të shtypura (Snowing, M. J, 2006). Ky sistem arrihet si një rrjet, në të cilin neuronet lidhen përmes sinapseve dhe krijojnë një rrjetë të komplikuar nëpër të cilën kalon informacioni i ndijuar për t'u perceptuar në sistemin qendror, në tru. Deri vonë, njohja e neurobiologjisë së gjuhës është gjeneruar duke studiuar mosfunksionimet si pasojë e dëmtimeve në tru (Shaffer, D. R., & Kipp, K. (2007).

Gjuha kërkon që informacioni i marrur të mësohet dhe të ruhet në kujtesë. Treguesit e trurit për shqyrtimin e gjuhës-Neurozhvillimi dërgon në rregullimin dhe funksionimin e gjuhës të prodhuar në trurin e të rriturve. Ku në procesimi fonetik/fonologjik i cili lidhet specifikisht me perceptimin e të folurit, duke krijuar marrëdhënie ndërmjet strukturave dhe funksioneve të trurit që lidhen me perceptimin e gjuhës.

Përvec faktorëve të lartpërmendur që kanë ndikim të madh në nxënien e gjuhës së huaj, rëndësi të madhe ka edhe metodat se si mësohet gjuha.

3.4. Periudha kritike për mësimin e gjuhës

Hipoteza e periudhës kritike (the Critical Period Hypothesis) pohon se përvetësimi i gjuhës së parë duhet të ndodhë para se të bëhet kompletimi i lateralizimit cerebral, rreth moshës së pubertetit. Një

parashikim i kësaj hipoteze është se përvetësimi i gjuhës së dytë do të jetë relativisht i shpejtë, i suksesshëm dhe cilësisht i ngjashëm me gjuhën e parë vetëm nëse ndodh para moshës së pubertetit. Hipoteza e periudhës kritike siç është propozuar nga Lenneberg (1967) thotë se përvetësimi i gjuhës parësore duhet të ndodhë gjatë një periudhe kritike e cila përfundon në afërsi të moshës së pubertetit me krijimin e lateralizimit cerebral të funksionit. Një implikim i fortë i kësaj hipoteze është se proceset e përfshira në çdo përvetësim gjuhësor që ndodh pas moshës së pubertetit do të jenë cilësisht të ndryshme nga ato të përfshira në përvetësimin e gjuhës së parë. Një përfundim i zakonshëm, megjithëse jo absolutisht i nevojshëm, është se çdo mësim gjuhësor që ndodh pas moshës së pubertetit do të jetë më i ngadaltë dhe më pak i suksesshëm sesa mësimi normal i gjuhës së parë (Krashen 1975; Lenneberg 1967, 1969; Scovel 1969). Ka pak raste të raportuara të përvetësimit të suksesshëm të gjuhës së parë pas moshës së pubertetit. Buddenhagen (1971) raportoi krijimin e suksesshëm të gjuhës verbale në një prapambetje mendore të heshtur më parë në moshën 18 vjeç. Raportet e fundit për Genie, një vajzë e izoluar nga ndërveprimi shoqëror deri në moshën 13 vjeç, sugjerojnë që megjithëse përvetësimi i gjuhës së saj është shumë i ngadaltë, ai është në shumë aspekte ndjekin të njëjtën kurs me atë të nxënësve të rinj të gjuhës së parë (Fromkin, Krashen, Curtiss, Rigler, & Rigler 1974), dhe aftësitë e saj gjuhësore po vazhdojnë të përmirësohen disa vjet pas pubertetit (Cur-hetic, Fromkin, Rigler, Rigler, & Krashen, 1975). Numri shumë i vogël i çështjeve të lëndëve pas lindjes pa asnjë gjuhë dhe rrethanat anormale që shoqërohen me ato raste e bëjnë jashtëzakonisht të vështirë të nxjerrim ndonjë përfundim të përgjithshëm, por gjetjet e Buddenhagen dhe ato që kanë të bëjnë me Genie sugjerojnë se një farë mase e parë e gjuhës pasubertale është e mundur. Një fushë tjetër për mbledhjen e të dhënave të rëndësishme është përvetësimi i gjuhës së dytë. Dy modele hulumtuese mund të pritet të prodhojnë të dhëna të rëndësishme për vlerësimin e : (1) krahasimin e njohjes së gjuhës së dytë me përvetësimin e gjuhës së parë; (2) kompromentimi i përvetësimit të gjuhës së dytë në një gamë të gjerë moshe, në mënyrë që lëndët më të reja të testuara të jenë akoma mirë brenda periudhës kritike të moshës.

Që prej kohës së teorisë së Lenneberg kërkime të ndryshme janë fokusuar në faktin nëse ekziston në të vërtetë një periudhë kritike për mësimin e gjuhës tek njerëzit. Këto studime kanë arritur të mbështesin ekzistencën e kësaj periudhe (veçanërisht në mësimin e fonologjisë dhe gramatikës së gjuhës), pavarësisht se jo të gjitha studimet kanë mbështetur hipotezën specifike të Lenneberg rreth marrëdhënies mes lateralizimit dhe përfundimit të periudhës kritike.

Në këtë model aftësitë gjuhësore shihen si të përshtatura dhe të favorizuara nga seleksionimi natyror, ndërsa periudha kritike për mësimin e gjuhës nuk është një përshtatje, por më së shumti buron nga ndërthurja e faktorëve gjenetikë me ato të personave të tjerë të rëndësishëm në jetën e fëmijës (Hurford, J. R,1991). Literatura e shqyrtuar në lidhje me periudhën kritike të mësimin të gjuhës grupohet në katër burime të dhënash. Grupi i parë i studimeve lidhet me rastet e studimit të individëve që janë të deprivuar që në foshnjëri. Ky kritikizëm nuk aplikohet në llojin e dytë të studimit për fëmijët, të cilët kanë jetuar për një kohë të konsiderueshme me probleme të dëgjimit të padiagnostikuara dhe nën presionin e gjuhës së shenjave dhe të folurit. (Locke, J. L,1997). Tipi i tretë i studimeve, përfshijnë të mësuarin e gjuhës së huaj nga fëmijët, familjet e të cilëve kanë emigruar në një kulturë me gjuhë të ndryshme nga ajo amtare. Tipi i katërt i studimeve fokusohet tek fëmijët që kanë dëmtime të njëanshëm të trurit. Këto studime kanë treguar se shumë fëmijë që kanë përjetuar dëmtime të rëndësishme në zonat e afërta të gjuhës, në hemisferën e majtë të trurit, vazhdojnë të mësojnë normalisht gjuhën e folur, pavarësisht se kur ka ndodhur saktësisht dëmtimi.

3.5. Metodat e përshtatshme për mësimin e gjuhës së huaj

Metoda audio gjuhësore(Audio-lingual Method)- synon të zhvillojë kompetencën komunikuese të fëmijëve përmes dialogut. Përdorimi i dialogëve dhe stërvitjeve janë efektive në mësimin e gjuhëve të huaja, pasi ato i çojnë fëmijët të prodhojnë të folur. Përsëritja e dialogëve dhe stërvitjeve do t'i lejojë fëmijët të përgjigjen shpejt dhe saktë në gjuhën e folur.

Qëllimi i metodës Audio-Linguale është përdorimi i gjuhës së synuar në mënyrë komunikuese. Sipas kësaj metode, fjalës i jepet përparësi në mësimin e gjuhëve të huaja. Metoda AudioLingual mëson gjuhën përmes dialogëve që përqendrohen në formimin e zakonit të fëmijëve . Dialogjet dhe stërvitjet model që duhet të përsërisin fëmijët, shpesh përdoren për të formuar zakone. Prandaj, siç thotë Larsen-Freeman (2000) sa më shpesh diçka përsëritet, aq më i fortë është zakoni dhe aq më i madh është mësimi. Përmes përsëritjes fëmijët mund të përdorin gjuhën e synuar automatikisht, dhe rrjedhshëm gjithashtu.

Metoda Audio-Gjuhësore dhe Zhvillimi i të folurit përqendrohet në aftësitë gojore. Ai synon të përmirësojë arritjet e të folurit të fëmijëve, në mënyrë që ata të mësojnë aftësi gjuhësore në mënyrë efektive, të mundësojë që fëmijët të përgjigjen shpejt dhe me saktësi në gjuhën e folur.

Brown (2001) shprehet se aktivitetet Audio-linguale paraqiten jo vetëm në shkurtime modele, por edhe në shumëllojshmëri dialogu, të cilat fëmijët duhet të dëgjojnë, përsërisin dhe memorizoni (Brown, 2001).

Prandaj, dialogët janë shumë të rëndësishëm në kuptimin që ato u siguroj fëmijëve strukturën e duhur dhe një ide se si të përdorin llojet e ndryshme të modele në situata të duhura sepse dialogët zakonisht ilustrojnë situata socio-kulturore të gjuha e synuar, d.m.th., veprimet e të folurit, të tilla si përshëndetjet, duke treguar miratimin ose mosmiratimin, shkëmbimi i opinionëve ose diskutimi i temave standarde (moti, hobi...etj). Teknika e Metodës Audio-Gjuhësore Larsen (2000) ofron përshkrime të zgjeruara të disa teknikave të zakonshme ose tipike të lidhura ngushtë me Metoda Audio-Gjuhësore. Renditja këtu është si më poshtë:

1. Memorizimi i dialogut (Memorizing the dialogue): Fëmijët mësojnë përmendësh një dialog të hapur duke përdorur mimikën dhe interpretimin e roleve.
2. Stërvitja e pyetjes dhe përgjigjes (Question and answer training): Fëmijët duhet të përgjigjen ose të bëjnë pyetje njërit-tjetrit. Përfundim dialogun.
3. Lojërat gramatikore (Grammar Games): Lojëra të ndryshme të krijuara për të praktikuar një pikë gramatikore në kontekst, duke përdorur shumë përsëritje.

Metoda (Total Physical Response) Përgjigje Totale Fizike është një metodë e mësimin të një gjuhe të huaj ose të dytë (gjuhë e synuar) duke zhvilluar kuptueshmërinë e të dëgjuarit përmes një serie komandash të cilit fëmijët i përgjigjen me aktivitet fizik. Ajo u themelua nga James Asher, profesor i psikologjisë, në fund të viteve 1960 dhe ende konsiderohet dhe përdoret si një mjet i vlefshëm gjuhësor në mësimin e një gjuhe të synuar, veçanërisht në fazat fillestare të mësimin. Ai kombinon gjuhën dhe gjestin, duke e bërë kështu përvetësimin e gjuhës më të natyrshëm dhe të paharrueshëm (Asher 2007; Curtain and Dahlberg 2010; Larsen-Freeman 2004; Morley 2001).

Duke përfshirë imitimin dhe luajtjen e roleve e cila zakonisht ka të bëjë me një këngë tradicionale dhe përqendrohet në sjelljen e gjuhës së këngëve me simulim. Duke përdorur simulim dhe dramatizëm fëmijët veprojnë përmes këngëve tradicionale, siç është një ndër këngët e njohura e veprimin (Head, shoulders, knees and toes) Koka, supet, gjunjët dhe gishtërinjtë, në të cilët fëmijët prekin pjesët përkatëse të trupit, duke kryer kështu një ushtrim fizik që kërkon që ata të përkulen

përpara dhe të shtrembërohen. Veprimet mund të prezantohen dhe praktikohen para tregimit, dhe pas kësaj të kryhen gjatë tregimit të tregimit (Shin 2014, 221). Në këtë mënyrë, tregimi i tregimeve është më aktiv dhe i kënaqshëm, dhe veprime me kuptim dhe kontekstualizim, duke kërcyer, duke rënë, duke thirrur dhe duke fjetur. Këto aktivitete mund ta bëjnë historinë të paharrueshme.

Natyrisht, këto nuk janë metodat e vetme për mësimin e gjuhës së huaj. Metoda të tjera aplikohen dhe ofrohen me qëllim të nxënies, duke marrë parasysh ambientin ku zhvillohet fëmija, disponimi i fëmijes, dëshira dhe casja që dëshiron fëmija të ketë për mesim, ku të mirëseardhur dhe shumë të dëshirueshme janë edhe librat me ilustrime, që nxisin kureshtjen, mendimin kritik, por edhe e shtyjne fëmijen të analizojë situata të prezantuara në libra.

3.6. Librat me ilustrime

Pikturat, pamjet, fotografitë tregojnë më shumë nga sa mund të tregojnë fjalët, veçanërisht tek foshnjat dhe fëmijët parashkollorë, të cilët nuk e njohin simbolikën e shumicës së fjalëve në gjuhën e tyre. Ilustrimet përdoren për të shoqëruar tekstin, duke krijuar një marrëdhënie të lehtë dekorative, emocion-nxitëse dhe kontrolluese dhe marrëdhënie të fortë përsëritëse, organizuese, rrëfyese, përmbledhëse dhe shpjeguese (Marsh, E.E., & White, M.D. 2003).

Librat e fëmijëve (children's books) duhet patjetër të përmbajnë ilustrime të cilat shërbejnë për të shpjeguar, interpretuar ose dekoruar tekstin e shkruar (Bodmer, G. R. 1992). Fang më 1996, theksoi rëndësinë e ilustrimeve të librave për fëmijë, për të rritur kuptimin e historisë. Ilustrimet që shoqërojnë tekstin përcaktojnë më së miri skenën ku zhvillohen ngjarjet duke ofruar detaje pamore të saj. Ato përcaktojnë dhe zhvillojnë personazhet kryesore dhe dytësore, me tiparet e tyre. Po ashtu, i ejojnë fëmijët të shohin edhe personazhet që ndërveprojnë me heronjtë e historisë, p.sh. prindërit apo kafshët shtëpiake.

Nëpërmjet ilustrimeve zhvillohet fabula duke treguar më shumë detaje për ndodhitë ndërmjet aktiviteteve të bëra nga heronjtë, apo duke u paraprirë disa ngjarjeve. Për shembull, është e lehtë që fëmijët t'i paraprijnë dialogut të Borëbardhës, kur shohin që gjugjat po thkehen në shtëpi.

Mënyra sesi u lexohet fëmijëve është shumë e rëndësishme, sepse mënyra e leximit për fëmijën ndikon në aftësitë e tyre gjuhësore. Kur një mësuese lexon për grupin, fëmijët janë të gjithë të ulur përballë librit dhe mësuesja mban librin në një pozicion të dukshëm mbi nivelin e fëmijëve si skena

e mini-teatrit të kukullave që ata kanë në kopsht .Kjo mundëson shikueshmërinë e ilustrimeve, të cilat shtojnë fakte të rëndësishme që teksti nuk i tregon përgjatë leximit, ose thjesht, mund të tregojnë sesi duket skena apo personazhet e ngjarjes. Në rastë kur i'u lexojmë një grupi fëmijëve, nevojitet që, t'i tregojnë me gisht fjalët, të ndjekim me gisht rreshtat ndërsa lexojmë dhe të tregojmë, po me gisht, figurat ilustruese. Disa libra janë plotësisht pa fjalë, dhe ata i paraqesin të gjitha ngjarjet vetëm nëpërmjet figurave (Fang, Z. (1996). Që të ruhet përqëndrimi i fëmijëve, lexojmë duke ndryshuar zërat sipas personazheve, në një formë aktrimi ku edhe fëmija përfshihet dhe e shijon edhe më shumë leximin. Ndërsa lexojmë një tregim, ne duhet të jemi të vetëdijshëm për pozicionin e trupit tonë, gjestikulacionit, kontaktin me sy me fëmijët, ndryshueshmërinë e zërit tonë. Por, secili nga ne do të ketë mënyrën dhe metodat e veçanta të leximit (Hahn, M. L.2002). Që fëmijët të krijojnë lidhja pozitive me leximin dhe librat, ne do jemi shembull për ta duke krijuar modelin entuzias dhe angazhimin e tyre. Norma mesatare e leximit për parashkollorët për kënaqësi duhet të jetë 15-30 minuta çdo ditë (Munson-Benson, C. 2005).

Për të ruajtur stilin të leximit me zëra të ndryshëm, tërheqës dhe të gjallë, në leximin në grup do të nevojitet që lexuesi/ja të mbajë një nivel më të lartë zëri për të arritur te të gjithë dëgjuesit. Leximi i efektshëm nevojitet të jetë pjesërisht ndërveprues. Fëmijët humbasin përqëndrimin nëse do t'u lexohen 206 fjalë nga teksti pa u dhënë atyre rastë të tregojnë një objekt apo kafshë që duket lehtësisht në ilustrim (Fang, Z.1996). Disa fëmijë më aktivë do të jenë në gjendje të tregojnë personazhet, objektet, figurat edhe pa u pyetur nga lexuesi i rritur.

Sfida në leximin në grup është se fëmijët nuk kanë të gjithë të njëjtin nivel kuptueshmërie dhe nuk kanë të njëjtën eksperiencë leximi. Jo të gjithë fëmijëve u lexohet në shtëpi njësoj, për pasojë, fëmijët do të kenë stërvitur vëmendjen e tyre në nivele të ndryshme. Duhet të bëjnë durim me një fëmijë që po mëson të dëgjojë dhe të kushtojë vëmendje, duke shmangur televizionin apo objekte të tjera që mund t'u tërheqin vëmendjen, duke eksperimentuar me histori më të sofistikuara për të parë nëse fëmija kërkon më shumë stimul për të qenë i përfshirë, gjithsesi, se librat me më pak ilustrime dhe më shumë tekst do të përshpejtojnë përparimin e fëmijës Kombinimi i tekstit intrigues, artit dhe temave që gjenden në librat me ilustrime i ushqejnë fëmijët me ide, stimulojnë imagjinatën dhe kuriozitetin e tyre dhe u dhurojnë atyre një fjalor të pasur për t'u përdorur në diskutimet dhe pyetjet në lidhje me librin.

Në zhvillimin e aftësisë së fëmijës për të folur, mësuesi mund të zgjedhë strategji dhe metoda, aktivitetet që mund të bëhen në zhvillimin e aftësive gjuhësore janë aktivitete që stimulojnë

aftësinë e të dëgjuarit, të folurit dhe të shkruarit, tregimi i tregimit është një nga metodat që përdoren gjerësisht nga mësuesit dhe duhet të jenë interesante, si dhe të ftojnë vëmendjen e fëmijëve dhe gjithashtu mund të ndahen nga qëllimi i edukimit të hershëm të fëmijërisë.

4.KONKLUDIME DHE REKOMANDIMET

Pasi që gjuha angleze ka filluar të jetë pjesë në edukimin parashkollor, studiues të ndryshëm tregojnë mbi zhvillimin e gjuhës në këtë moshë si fëmijët mësojnë një gjuhë të huaj në këtë moshë kaq të vogël. Sipas Anderson & Graham, 1994 sa më herët që njeriu të mësojë një gjuhë të dytë,

aq më afër të folurit original do të jetë shqiptimi i tij. Chomski (2004) argumenton se aftësia e fëmijëve (the ability of children) për të mësuar gjuhë është për shkak të një organi të programuar gjenetikisht që ndodhet në tru. Pasi fëmijët lindin dhe përfshihen në mjedise gjuhësore, ata menjëherë fillojnë të zhvillojnë një gjuhë. Nga ajo se cka u diskutua ne kapitullin e mëparshëm, dhe për t'ju përgjigjur pyetjes :”Cka ndikon në nxënien e gjuhës së huaj te fëmijet parashkollor?”, u vërejt se ka shumë faktorë që ndikojnë në nxënien e gjuhës në vecanti, dhe gjithashtu edhe gjuhës së huaj. Moshë ishte një faktor i rëndësishëm për mësimin e gjuhës së huaj.

Nëse fëmiju është i ekspozuar në një ambient ku flitet një gjuhë e huaj, atëherë ai fëmijë fillon ta mësojë atë (dhe atë në mënyrë spontane). Sidoqoftë, nëse fëmijes i ofrohet/ prezantohet një gjuhë në mënyrë të qëllimshme , atëherë domosdo që do ta mësojë. Me kalimin e moshës, edhe mesimi i gjuhës së huaj bëhet më i vështirë. Pra, faktor që ndikon në mësimin e gjuhës së huaj, në kushtet optimale të zhvillimit, si: ambienti jokërcnues, mjetet mësimore, teknologjia është moshë që ndikon në nxënien e gjuhës së huaj, d.m.th zhvillimi Neurobiologjik i gjuhës tek fëmijët.

Kurse, për t'ju përgjigjur pyetjes së dytë: “Cilat janë metodat më të përshtatshme për të mësuar një gjuhë të huaj një fëmijë parashkollor?”, Larsen-Freeman (2000) thekson se Audio-Lingual Method (Metoda Audio-Linguale) dhe Total Physical Response (TPR), janë metodat më të përshtatshme për fëmijet parashkollorë. Me metodën e parë, fëmijet mund të dëgjojnë gjuhë tjetër, (për shembull një këngë fëmijësh), dhe ata fillojnë t'a këndojnë vetëm duke e dëgjuar atë vazhdimisht. E njëjta është edhe me TPR kur me këngë të thjeshta ritmike fëmijët i thonë fjalët (e thjeshta), dhe i ndjekin udhëzimet se cka thuhet: p.sh. Head and Shoulders (Koka dhe krahet), apo Teddy Bear, Teddy Bear Touch the ground- kur fëmijet do prekin tokën. Në këtë mënyrë ata pasurojnë fjalorin e tyre me fjalë të huaja, e të thjeshta.

Si përfundim, mbi zhvillimin e gjuhës është e rëndësishme përdorimi i metodës Audio-Linguale, për përdorimin e gjuhës së synuar në mënyrë komunikuese. Sipas kësaj metode, fjalës i jepet përparësi në mësimin e gjuhëve të huaja. Metoda AudioLingual mëson gjuhën përmes dialogjeve që përqendrohen në formimin e zakonit të fëmijëve. Ndërsa metoda tjetër po ashtu e rëndësishme është metoda Total Physical Response (TPR), metodë e mësimin të një gjuhe të huaj duke zhvilluar kuptueshmërinë e të dëgjuarit përmes një serie komandash të cilit fëmijët i përgjigjen me aktivitet fizik.

Duke u bazuar në studime, fëmijët e moshës parashkollorë në bazë të zhvillimit të tyre nxëne më shpejt. Mjetet e mesimit, sidomos librat janë edhe një faktor i rëndësishëm që nxisin kureshtjen e

fëmijëve, dhe natyrisht, pregaditen për moshën më të rritur se si të përdoret libri dhe si të nxisin mendimin kritik dhe kreativitetin. Në rast tonë, në mësimin e gjuhës angleze me libra me ilustrime të përshtatshme për grupmosha të ndryshme.

Prandaj ky hulumtim rekomandon:

1. Gjuha angleze të ofrohet në të gjitha institucionet, private dhe publike.
2. Në raste të pa mundësise të mësueses përkatëse të gjuhës angleze, edukatorët të përdorin burimet pa kosto të larte si internetin, duke përdorur materiale plotësuese (kaseta video, filma dokumentarë, aktivitete drama, projekte, kuize, etj).
3. Çdo mësuese në edukimin parashkollor të trajnohet për të mësuar termet bazë të gjuhës angleze dhe t'i përdori për hulumtime për edukim të fëmijëve.
4. Duke siguruar një ambient të sigurt të zhillohen sa më shumë aktivitete që përfshijnë gjuhën angleze në lojë, në natyrë, këngë, dhe libra me ilustrime, gjithashtu edhe duke u ofruar fëmijëve mundësi të mësimimit spontan të gjuhës angleze, përmes teknologjisë.
5. Nëse në institucionin përkatës nuk mësohet gjuha angleze, prindërit në rast mundësie t'i dërgojnë fëmijët në kurse, ose në shtëpi duke shfrytëzuar internetin me video edukative.

Është e qartë se fëmijët mësojnë më shpejt fjalë të reja nëse shohin një pamje, vizatim, pikturë që e ilustron fjalën dhe në të njëjtën kohë ta dëgjojnë atë. Përdorimi i shenjave dhe fjalëve në të njëjtën kohë e ndihmon fëmijën të kuptojë më shpejt fjalët dhe të aftësohet në komunikim si dhe në rritjen e fjalorit të tyre. Duke u nisur nga fakti se gjuha angleze është gjuha dominuese në botë, dhe që edhe në Kosovë po kërkohet dhe po ofrohet si lëndë në institucione të ndryshme fillore, madje edhe në parafillore, fëmijëve parashkollor duhet t'u ofrohet mundësia që të kenë çasje në çdo mënyrë të mundshme për të mësuar gjuhën angleze.

Fëmijëve duhet t'u ipet hapësira dhe mundësia për mësimin e mirëfillte të të gjitha aftësive të nevojshme të shekullit 21të: mendimin kritik, kreativitetin, bashkëpunimin, natyrën, shoqërinë, por edhe mësimin e gjuhës të huaj. Nëse një fëmijë i përqafton aftësitë e lartpërmendura do të ketë mundësi të adoptohet, modifikohet dhe integrohet me ndryshimet dhe kërkesat e shoqërisë së këtij shekulli.

LITERATURA

Asher, J. (2007). TPR: After forty years, still a very good idea. Retrieved on 10 July 2013

from: <http://www.tpr-world.com/japan-article.html>.

Buddenhagen, R. G. Establishing vocal verbalisations in mute mongoloid children. Champaign, Ill.: Research Press, 1971.

Brown, H.D. (2001). Teaching by Principles: An interactive Approach to Language pedagogy; 2nd Ed. New York: Pearson Education Company.

Bodmer, G. R. (1992). Approaching the Illustrated Text. Në G. E. Sadler, Teaching Children's Literature (fv. 72-79). NY: The modern Language Association of America

Curtain, H. & A. Dahlberg (2010). Languages and Children, Making the Match: New Languages for Young Learners, Grades K-8. Boston: Pearson Education Inc.

Chomsky, N. (2006). Language and Mind (bot. i 3). New York: Cambridge University Press.,

Chomsky, N. (1965). Aspects of the Theory of Syntax. Cambridge, Massachusetts: MIT Press.

Chomsky, N. (2004). Knowledge of Language as a Focus of Inquiry. In Lust, B., & Foley, C (eds). First language acquisition: The essential readings

De Temple, J., & Snow, C. E. (2003). Learning words from books. Në A. van Kleeck.

Fromkin, V.; Krashen, S.; Curtiss, S.; Rigler, D.; & Rigler, M. The development of language in Genie: a case of language acquisition beyond the "critical period." Brain and Language, 1974.

Fang, Z. (1996). Illustrations, Text, and the Child Reader: Èhat are Pictures in Children's Storybooks for? Reading Horizons.

Hurford, J. R. (1991). The Evolution of the Critical Period for Language Acquisition. Cognition.

Hahn, M. L. (2002). Reconsidering Read-Aloud. Portland: Stenhouse Publishers

Krashen, S. (1975). The critical period for language acquisition and its possible bases. In D. Aaronson & R. W. Rieber (Eds.), Developmental psycholinguistics and communication disorders. New York: New York Academy of Sciences, 1975

Lenneberg, E. Biological foundations of language. New York: Wiley, 1967.

Locke, J. L. (1997). A Theory of Neurolinguistic Development. Brain and Language

Larsen-Freeman, D. (2000). "Techniques and principles in language teaching." Oxford University Press.

Marsh, E. E., & Ęhite, M. D. (2003). A Taxonomy of Relationships Between Images and Text. Journal of Documentation

Munson-Benson, C. (2005). Playful Reading: Positive, Fun Ways to Build the Bond Between Preschoolers, Books, and You. Minneapolis: Search Institute

MASHT. (2017) Plani dhe programi mĕsmor, klasa pĕrgatitore. Prishtinĕ.

Morley, J. (2001). Aural Comprehension Instruction: Principles and Practices. In Celce-

Murcia, M. (Ed.) Teaching English as a Second or Foreign Language, 3rd edition, 69-85.

Boston: Heinle Cengage Learning

Noam Chomsky. untitled. Broadcast as part of an interview on Brian Magee's BBC television series – Men of Ideas. Also included in a book of the same name, 1978.

Piaget, J. (1970). Genetic Epistemology. New York: W. W. Norton & Company. INC

Sigelman, C. K., & Rider, E. A. (2009). Life-Span Human Development. Belmont: Wadsworth Cengage Learning.

Slavin, R.E. (1988). Educational psychology theory into practice. (2nd ed). Englewood Cliffs, N. J.: Prentice Hall

Summary of Presentation by Prof. Murray on Piaget and Cognitive Development
<http://www.udel.edu/billf/armen2.html>

Snowling, M. J. (2006). *Language Skills and Learning to Read: The Dyslexia Spectrum*. Në M. J. Stackhouse, *Dyslexia, Speech and Language: A Practitioner's Handbook* (fv. 1-14). West Sussex: Whurr Publishers Limited.

Shaffer, D. R., & Kipp, K. (2007). *Developmental Psychology: Childhood & Adolescence* (bot. i 7). Belmont: Thomson Wadsworth.

Shin, J. K. (2014). *Teaching Young Language Learners: From theory to practice*. Boston:

Heinle, Cengage Learning.

Tooby, J. and L. Cosmides. 2005. *Evolutionary psychology: Conceptual foundations*. *Evolutionary psychology handbook*. New York: Wiley.

Zgourides, G. (2000). *Developmental Psychology*. Foster City: IDG Books Worldwide.